

*Energji Ashta*

**Energji Ashta Sh.p.k**  
**Pasqyrat Financiare**  
**për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

**Përmbajtja**

	<u>Faqe</u>
Raporti i Audituesve të Pavarur	
Pasqyra e pozicionit financiar	5
Pasqyra e performancës financiare	6
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	7
Pasqyra e flukseve monetare	8
Shënime për pasqyrat financiare	9-23



## Raporti i Audituesit të Pavarur

Për Aksionarët e Shoqërisë Energji Ashta Sh.p.k,

### Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë Energji Ashta Sh.p.k (më poshtë "Shoqëria") që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2018, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, dhe një përmbledhje të politikave kontabël dhe informacione të tjera sqaruese, të përfshira nga faqja 9 deri në faqen 23.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të Energji Ashta Sh.p.k paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2018, performancën e saj financiare dhe fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur dhe ndryshimet në kapital në atë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

### Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit Ndërkombëtar për Standardet e Etikës (Kodi i IESBA) dhe Kodit të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (Kodi i IEKA), së bashku me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 mars 2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilitetit të miratuar" të amenduar, që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

TPA Albania shpk

Rr Reshit Çollaku, Pall Shalivare, Apt 44, 1000 Tirana, Albania

[www.tpa-group.com](http://www.tpa-group.com)

Albania | Austria | Bulgaria | Croatia | Czech Republic | Hungary | Montenegro | Poland | Romania | Serbia | Slovakia | Slovenia

## **Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen Për Pasqyrat Financiare**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon si të nevojshme për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijmësisë, për shënimet shpjeguese për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likujdojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveç sa më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

### **Përgjegjësia e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomaliave materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të njajftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, koqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontroleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrothanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijmësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijmësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të

**TPA Albania sh.p.k**

Rr Reshit Collaku, Palli Shalvare, Apt 44, 1000 Tirana, Albania

[www.tpa-group.com](http://www.tpa-group.com)

Albania | Austria | Bulgaria | Croatia | Czech Republic | Hungary | Montenegro | Poland | Romania | Serbia | Slovakia | Slovenia

auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme në duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijëmesi.

Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Në komunikojmë me personat të ngarkuar me qeverisjen e Shoqërisë Energji Ashta Sh.p.k., përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Date 07 June 2019



Ilir Binaj, CPA, CGMA, Auditor Ligjor



TPA Albania shpk

Rr Rreshit Collaku, Paç Shalivane, Apt 44, 1000 Tirana, Albania

www.tpa-group.com

Albania | Austria | Bulgaria | Croatia | Czech Republic | Hungary | Montenegro | Poland | Romania | Serbia | Slovakia | Slovenia

**Energji Ashta Sh.p.k.**

Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2018

(Shumat në Lek)

	Shënime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
<b>Aktivet</b>			
<b>Aktivet afatshkurtra</b>			
Mjetet monetare	4	59,106,574	35,183,082
Depozita e mjete monetare te kufizuara	5	30,913,222	18,283,222
Aktive te tjera	6	8,360,102	8,399,990
Llogari të arkëtueshme	7	275,685,280	302,721,022
Inventari		103,200,714	101,591,121
Parapagime dhe shpenzime te shtyra		13,937,890	15,789,660
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>491,203,783</b>	<b>481,968,097</b>
<b>Aktivet afatgjata</b>			
Aktive afatgjata materiale	8	34,143,941	37,684,024
Aktive afatgjata të jo materiale	9	19,267,072,591	20,042,927,863
Aktive nga tatimi i shtyre	17	720,328,116	-
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>20,021,544,649</b>	<b>20,080,611,887</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>20,512,748,431</b>	<b>20,562,579,984</b>
<b>Kapitali</b>			
Kapitali aksionar	10	12,460,176,500	12,460,176,500
Humbje të akumuluar		(5,194,125,772)	(7,311,614,979)
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>7,266,050,728</b>	<b>5,148,561,521</b>
<b>Detyrimet</b>			
<b>Detyrimet afatshkurtra</b>			
Detyrime ndaj palëve te lidhura	11	239,430,452	577,004,708
Të pagueshme ndaj furnitorëve	12	44,043,443	74,685,155
Pjesa afatshkurtër e huave afatgjata	13	956,065,642	1,035,241,100
Tatim Fitimi	17	127,983,166	-
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>1,367,522,703</b>	<b>1,686,930,963</b>
<b>Detyrimet afatgjata</b>			
Hua afatgjata	13	11,879,175,000	13,727,087,500
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>11,879,175,000</b>	<b>13,727,087,500</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>13,246,697,703</b>	<b>15,414,018,463</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>20,512,748,431</b>	<b>20,562,579,984</b>

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të paraqitura në faqet 9 deri 23.

**Energji Ashta Sh.p.k.**

Pasqyra e performancës financiare per vitin e mbyllur 31 dhjetor 2018

*(Amounts in Lek)*

	<b>Shënime</b>	<b>2018</b>	<b>2017</b>
Të ardhura	14	2,346,940,852	1,473,364,421
Kosto personeli	15	(54,750,113)	(53,431,891)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	8, 9	(783,941,048)	(783,724,794)
Shpenzime të tjera operative	16	(201,947,625)	(282,079,226)
Te ardhura te tjera operative		62,666	114,283
<b>Rezultati nga veprimtaria operative</b>		<b>1,306,364,731</b>	<b>354,242,793</b>
Të ardhura nga interesi		270,000	70,000
Interesi dhe shpenzime të tjera		(504,835,276)	(562,590,719)
Tarifa te garancive		(303,713,313)	(336,428,116)
Fitimi/(humbja) neto nga kurset e këmbimit		1,027,058,115	252,930,384
<b>Kosto financiare neto</b>		<b>218,779,525</b>	<b>(646,018,452)</b>
<b>Fitimi/(humbja) e vitit para tatimit</b>		<b>1,525,144,256</b>	<b>(291,775,659)</b>
Shpenzimet e tatim fitimit	17	(127,983,166)	-
Shpenzime (benefite) nga aktivet tatimore te shtyra	17	720,328,116	-
<b>Fitimi/(humbja) neto e vitit</b>		<b>2,117,489,206</b>	<b>(291,775,659)</b>

Pasqyra e performancës financiare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të paraqitura në faqet 9 deri 23.

**Energji Ashta Sh.p.k.**

**Pasqyra e ndryshimeve në kapital per vitin e mbylltur 31 dhjetor 2018**

*(Amounts in Lek)*

	<u>Kapitali i aksioner</u>	<u>Humbje të mbartura</u>	<u>Total</u>
Gjendja më 1 Janar 2017	<u>12,460,176,500</u>	<u>(7,019,839,321)</u>	<u>5,440,337,180</u>
Fitimi i vitit		(291,775,657)	(291,775,657)
Kontribute nga ortakët			
Gjendja më 31 Dhjetor 2017	<u>12,460,176,500</u>	<u>(7,311,614,979)</u>	<u>5,148,561,521</u>
Humbja e vitit		2,117,489,206	2,117,489,206
Kontribute nga ortakët			
Gjendja më 31 Dhjetor 2018	<u>12,460,176,500</u>	<u>(5,194,125,773)</u>	<u>7,266,050,727</u>

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënime të shpjegueshme që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të paraqitura në faqet 9 deri 23. Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Drejtimi i Energji Ashta Sh.p.k. më 28 Mars 2019 dhe nënshkruar nga:

  
Peter Stelzer  
Administratori



  
Dorian Reiser  
Administratori



**Energji Ashta Sh.p.k.**

Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2018

(Shumat në Lek)

	2018	2017
<b>Fluksi nga veprimtaritë operative</b>		
Fitimi/(humbja) para tatimit	1,525,144,256	(291,775,659)
<i>Rregullime për:</i>		
Zhvlerësimi dhe amortizimi (8,9)	783,941,048	783,724,794
Humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve	-	-
Shpenzime interesi	808,548,590	899,018,836
Të ardhura nga interesi	(270,000)	(70,000)
	<b>3,117,363,894</b>	<b>1,390,897,971</b>
<i>Ndryshime në:</i>		
Parapagime, të arkëtueshme, aktive të tjera	28,927,398	776,881,841
Depozita e mjeteve monetare të kufizuara	(12,630,000)	(7,927,222)
Inventar	(1,609,592)	(4,388,323)
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	(337,574,256)	(29,865,918)
Te pagueshme ndaj furnitorëve dhe detyrime të tjera	(30,641,712)	14,586,661
<b>Mjete monetare nga veprimtaritë operative</b>	<b>2,763,835,731</b>	<b>2,140,185,010</b>
Tatim fitimi i paguar	-	-
Interes i paguar	(808,548,590)	(899,018,836)
Te ardhura nga interesi	270,000	70,000
<b>Mjete monetare (përdorur)/nga veprimtari operative</b>	<b>1,955,557,141</b>	<b>1,241,236,174</b>
<b>Fluks nga veprimtari investuese</b>		
Blerje e aktiveve të tjera të materiale	(4,545,693)	(8,185,378)
Blerje e aktiveve të tjera të jo-materiale	-	-
<b>Mjetet monetare përdorur në veprimtari investuese</b>	<b>(4,545,693)</b>	<b>(8,185,378)</b>
<b>Fluks nga veprimtari financuese</b>		
Te ardhurat neto/(pagesat e) të huasë	(1,927,087,958)	(1,205,039,578)
Rritje e kapitalit aksionar	-	-
<b>Mjetet monetare neto nga/(përdorur) në veprimtari financuese</b>	<b>(1,927,087,958)</b>	<b>(1,205,039,578)</b>
<b>Rritja neto/(ulja) e mjeteve monetare dhe ekuivalente</b>	<b>23,923,491</b>	<b>28,011,218</b>
Mjete monetare dhe ekuivalente me të në fillim të vitit	35,183,082	7,171,864
<b>Mjete monetare dhe ekuivalente me të më 31 dhjetor (shënimi 4)</b>	<b>59,106,573</b>	<b>35,183,082</b>

Pasqyra flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të paraqitura në faqet 9 deri 23.

## **Energji Ashta Sh.p.k.**

Shënime për pasqyrat financiare

(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

### **I. INFORMACION I PERGJITHSHEM**

Energji Ashta Sh.p.k. ("Shoqëria") është regjistruar në 11 dhjetor 2008. Zyra qendrore e shoqërisë është e vendosur në Shkoder, Shqipëri.

#### **Marrëveshja e koncesionit**

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 1363, datë 22 tetor 2008 "Për miratimin e Marrëveshjes së Koncesionit, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Österreichische Elektrizitätswirtschafts-Aktiengesellschaft, për ndërtimin, pronësinë, përdorimin dhe transferimin e projektit për Hidrocentralin e ri në Ashtë, në Republikën e Shqipërisë", Qeveria Shqiptare, përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës ("METE") dhe Shoqëria hynë në një Marrëveshje Koncesioni, datë 17 tetor 2008 ("Marrëveshja e Koncesionit").

Objektivi kryesor i Shoqërisë është zbatimi i Marrëveshjes së Koncesionit. Koncesioni jepet për një periudhë 35 vjeçare, duke filluar nga 17 tetori 2008. Bazuar në Marrëveshjen e Koncesionit Shoqërisë i caktohen si më poshtë:

- (i) projektimi, financimi, ndërtimi, testimi, zotërimi, veprimtaria dhe mirëmbajtja e hidrocentralit;
- (ii) pasurimi dhe rinovimi i objekteve ekzistuese, të zotërojnë pjesët e pasuruara dhe të rinovuara të objekteve ekzistuese sipas kërkesave ligjore dhe të përdore dhe mirëmbajë objektet ekzistuese;
- (iii) të gëzojë uzufruktet;
- (iv) të ketë të drejtë përdorimi të ujit në nivelin më të ulët të lumit Drin (brenda zonës së koncesionit);
- (v) të furnizojë KESH me prodhim të përkohshëm dhe me prodhim neto të energjisë elektrike dhe të mbledhë pagesat e blerësve në përputhje me kohën dhe kushtet e Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë, dhe t'i shesë palëve të treta prodhimin neto të energjisë elektrike në një treg të hapur;
- (vi) t'i rikthejë Qeverisë Shqiptare përdorimin e zonës së koncesionit dhe të drejtën për transferim, dhe t'i transferojë Qeverisë Shqiptare pronësinë e hidrocentralit dhe objekteve ekzistuese me përfundimin e periudhës së koncesionit;
- (vii) të ketë të drejtën ekskluzive mbi çdo atribut mjedisor të lindur nga projekti, duke përfshirë edhe certifikimet që lidhen me të.

Marrëveshja e koncesionit përmban një mundësi rinovimi.

Të ardhurat e njohura nga veprimtaria e hidrocentralit për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2018 dhe 2017 janë detajuar në shënimin 14.

Bazuar në marrëveshjen 'Off-Take' me KESH Sh.a ("KESH") më datë 30 shtator 2008, Shoqëria i faturon OSHEE sasine e deklaruar me cmimin e percaktuar.

#### **Kompensimi për shmangien nga prodhimi i deklaruar.**

Në rastet kur në çdo interval kohor gjatë ditës së shfrytëzimit, prodhimi faktik neto i energjisë elektrike (siç matet nga sistemi i matjes) është:

- (i) me i ulët se prodhimi i dispeceruar për këtë interval kohor shitesi do të kompensojë financiarisht OST ose
- (ii) nëse pas udhëzimit të OST, është me i lartë se prodhimi i deklaruar, atëherë shitesi do të kompensohet financiarisht nga OST.

Shuma e kompensimit do të llogaritet si diference ndërmjet prodhimit të deklaruar ose prodhimit të dispeceruar, sipas rastit, për atë interval kohor dhe prodhimin neto të energjisë elektrike, e shumezuar në çdo rast me cmimin përkatës të miratuar nga Rregullatori për shërbimet e balancimit të OST.

Në kuadër të ndryshimeve në sektorin energjetik, Ministria e Energjisë dhe Industrisë kerkoi transferimin e kontratës së shitjes së energjisë nga KESH tek OSHEE, duke filluar në data 1 Korrik 2016.

Shoqëria ka njohur një aktiv jo-material marrë si shpërblim për ndërtimin ose përmirësimin e shërbimeve në një marrëveshje koncesionare të shërbimeve (shih shënimin 9). Aktivin jo-material përfaqëson të drejtën për të shitur energji elektrike të prodhuar nga infrastruktura e koncesionit. Kostot e kapitalizuara të huamarrjes janë përfshirë në aktivin jo-material.

## **Energji Ashta Sh.p.k.**

Shënime për pasqyrat financiare

*(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)*

### **1. INFORMACION I PERGJITHSHEM (VAZHDIM)**

*Vlerësimi i menaxhimit mbi vijimësinë e aktivitetit*

Më 31 Dhjetor 2018, Shoqëria ka humbje të akumuluar prej 5,194,125,772Lek (2017: 7,311,614,979Lek) të cilat janë njohur gjatë fazës fillestare të investimit. Gjatë vitit 2013, Shoqëriaka përfunduar fazën e investimit dhe të ndërtimit dhe ka filluar prodhimin dhe shitjen e energjisë elektrike.

Fazat e nisjes financohet nga Grupet përkatëse në pronësi të të cilave është Pronari i Shoqërisë (shiko shënimet 10, 11 dhe 13). Përveç të pagueshmeve dhe huavetë marra nga palët e lidhura, në vitin 2015, kapitali aksionar është rritur me 1,677,720,000 lekë.

Drejtimi beson që Shoqëria do të jetë në gjendje të gjenerojë fitime në të ardhmen dhe aftësia e saj për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë nuk do të dëmtohet. Për këtë arsye, Shoqëriaka përgatitur pasqyrat financiare në bazë të parimit të vijimësisë.

### **2. BAZA E PËRGATITJES**

#### **(a) Deklarata e përputhshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

#### **(b) Baza e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi baza të kostos historike.

#### **(c) Monedha funksionale dhe raportuese**

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është dhe monedha funksionale dhe e prezantimit për Shoqërinë.

#### **(d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve**

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SKK kërkon që drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave dhe në shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të të ardhurave dhe shpenzimeve.

Vlerësimet dhe supozimet e përmendura rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen nëperiudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

#### **(e) Ndryshimet në politikat kontabël**

Si rezultat i NAS I3 Aktivitet Biologjike dhe Marrëveshjet e Koncesionit, ipërmirësuar, Shoqëria ka ndryshuar politikën e saj kontabël në kontabilizimin e marrëveshjeve koncesionare për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015. Si rezultat i ndryshimit, Shoqëria ka njohur një aktiv jo-material marrë në këmbim të ndërtimit ose përmirësimit të një aktiviteti në një marrëveshje koncesionare, ndërsamë parë këto aktive ishin njohur si aktive afatgjata të materiale. Jeta e dobishme e pritshme e aktiveve dhe metodat e zhvlerësimit dhe amortizimit kanë ndryshuar sipërshtetë politikën kontabël 3.a.

## **Energji Ashta Sh.p.k.**

Shënime për pasqyrat financiare

(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

### **3. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL**

#### **(a) Aktivët jo-materiale**

##### *(i) Marrëveshjet e Koncesionit*

Shoqëria njih një aktiv jo-material që rrjedh nga një marrëveshje koncesionare shërbimesh, kur ajo ka të drejtën për të shitur energjinë elektrike të prodhuar nga infrastruktura e koncesionit. Kjo nuk është një e drejtë e pakushtëzuar për të marrë para, pasi ajo është e varur nga sasia e energjisë elektrike së prodhuar nga hidrocentrali. Një aktiv jo-material marrë në këmbim të ndërtimit ose përmirësimit në një marrëveshje koncesionare shërbimi fillimisht matet me vlerën e drejtë duke iu referuar vlerës së drejtë të shërbimeve të ofruara.

##### *(ii) Kostot vijuese*

Pas njohjes fillestare, aktivi jo-material matet me koston, e cila përfshin kostot e kapitalizuara të huamarrjes, minus amortizimin dhe humbjet nga zhvlerësimi.

##### *(iii) Amortizimi*

Jeta e dobishme e pritshme e një aktivi jo-material në një marrëveshje koncesionare të shërbimeve është periudha nga momenti kur Shoqëria është në gjendje të përdore infrastrukturën deri në fund të periudhës së koncesionit. Amortizimi llogaritet duke përdorur metodën lineare dhe njihet si fitim ose humbje. Jeta e dobishme e vlerësuar koncesionit me datë 31 dhjetor 2014 është 29 vjet.

#### **(b) Aktivët afatgjata materiale**

##### *(i) Njohja dhe matja*

Aktivët afatgjata të materiale maten me kosto minus amortizimin e akumuluar (shih më poshtë) dhe humbjet nga rënia në vlerë, nëse ka. Kosto përfshin shpenzimet që lidhen drejtpërsëdrejti me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të ndërtuara vetë, përfshin koston e materialeve dhe punës direkte (nëse përfshihet), çdo kosto tjetër që lidhet drejtpërsëdrejti me përgatitjen e aktiveve për gjendje pune, për qëllimin e përdorimit të tyre; shpenzimet e çmontimit dhe heqjes së elementëve dhe rikthimin e terrenit ku ato ndodhen në gjendjen fillestare, dhe kostot e huamarrjes që lidhen me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e aktiveve përkatëse. Shpenzimet kapitale të ndodhura gjatë ndërtimit të aktivit, janë kapitalizuar në "aktive në proces" dhe transferohen në kategorinë e aktivit përkatës, kur ndërtimi të përfundojë. Aktivi do të amortizohet në bazë të kategorisë që do të klasifikohet.

Kur pjesë të një objekti të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si pjesë të veçanta (përbërës kryesorë) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitja e një objekti të aktiveve afatgjata materiale përcaktohen duke krahasuar të ardhurat nga shitja me vlerën e mbartur, dhe janë të njohura si të ardhura neto në kategorinë e të ardhurave të tjera, në fitim ose humbje.

##### *(ii) Kostot vijuese*

Kostot e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale shtohet vlerës së mbetur të elementit nëse është e mundur që përfitime ekonomike në të ardhmen që lidhen me këtë element do të rrjedhin në Shoqëri, dhe kostoja e tij mund të matet me saktësi. Kostot e mirëmbajtjeve të vazhdueshme të aktiveve afatgjata njihen në pasqyrën e performancës në momentin kur ndodhin.

## **Energji Ashta Sh.p.k.**

Shënime për pasqyrat financiare

(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

### **3. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIMI)**

#### **(b) Aktivet afatgjata materiale (vazhdim)**

##### *(iii) Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve materiale përllogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur, për periudhë aktuale dhe krahasuese, me norma si më poshtë:

	2018: Ne %	2017: Ne %
• Ndërtesa	-	-
• Makineri	-	-
• Instalime elektrike	-	-
• Aktive të tjera të materiale	20%-25%	20%-25%

Jetët e dobishme, metodat e amortizimit dhe vlerat e mbetura, nëse nuk janë jodomethënëse, rivelesohen në datën e raportimit. Toka dhe aktivet në proces nuk zhvlerësohen.

#### **(c) Inventari**

Inventari vlerësohet me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është çmimi i shitjes i vlerësuar në rrjedhën normale të aktivitetit të biznesit minus kostot e përfundimit dhe shpenzimet e shitjes. Kosto e inventarit përfshin të gjitha kostot e blerjes, kostot e shndërrimit dhe kosto të tjera të ndodhura me qëllim sjelljen e inventarit në gjendjen dhe vendndodhjen aktuale.

#### **(d) Instrumentet financiare**

Shoqëria mban vetëm instrumente financiare jo derivative, përfshirë llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera, mjete monetare dhe ekuivalentë të saj, hua, llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera.

Gjithë aktivet dhe detyrimet financiare njihen fillimisht në datën e blerjes në të cilën Shoqëria bëhet palë e parashikimeve kontraktuale të instrumentit. Një aktiv ose detyrim financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes ose emetimit të tij.

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale ndaj flukseve monetare që rrjedhin prej aktivit përfundojnë, ose ajo i transferon të drejtat për të marrë flukse monetare kontraktuale nga aktivi financiar nëpërmjet një transaksioni, ku në mënyrë thelbësore gjithë rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar transferohen.

Çdo interes mbi aktivet financiare të transferuara që krijohen ose mbahen nga Shoqëria, njihet si një aktiv ose detyrim i vecantë. Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet e saj kontraktuale shlyhen, anulohen, ose përfundojnë.

Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare jo-derivative maten siç përshkruhet më poshtë:

##### *Mjete monetare dhe ekuivalente me to*

Mjetet monetare dhe ekuivalentë me to përfshijnë paratë në arkë, llogari rrjedhëse në bankë, investime të tjera afatshkurtra me likuiditet të lartë me maturitet origjinal tre muaj ose më pak dhe përdoren nga Shoqëria në menaxhimin e angazhimeve të saj afatshkurtra. Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to mbarten me koston e amortizuar në bilancin kontabël.

##### *Huatë*

Huatë maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

##### *Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi.

##### *Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera*

Pas njohjes fillestare llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera njihen me koston e amortizuar.

#### **(e) Kapitali aksionar**

Kapitali aksionar i Shoqërisë njihet me vlerën nominale.

## **Energji Ashta Sh.p.k.**

Shënime për pasqyrat financiare

(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

### **3. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIMI)**

#### **(f) Provigjionet për risqe**

Një provigjion njihet kur Shoqëria, si pasojë e ngjarjeve të shkuara ka një detyrim aktual, ligjor ose strukturor, që mund të matet në mënyrë të besueshme, dhe është e mundur që të kërkohej një dalje e flukseve të të mirave ekonomike për të shlyer detyrimin. Provigjionet llogariten duke skontuar flukset e ardhshme monetare me një normë përpara tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike të detyrimit.

#### **(g) Të ardhurat**

Të ardhurat njihen atëherë kur rreziqet dhe përfitimet thelbësore të pronësisë janë transferuar tek blerësi, marrja e kompensimit është e mundur, kostot e lidhura dhe kthimet e mundshme të mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme, nuk ka përfshirje të mëtejshme të drejtimit në energjinë e shitur, si dhe shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme. Të ardhurat maten neto nga kthimet, zbritjet tregtare si dhe kompensimet e vëllimit. Për shitjen e energjisë elektrike, transferimi zakonisht ndodh kur sasia aktuale e energjisë është injektuar në rrjetin e transmetimit dhe është matur në pikën e furnizimit. Kompensimet e marra dhe të paguara bazuar në Marrëveshjen 'Off-Take' me OSHEESH.a njihen siç përshkruhen në shënimin I.

#### **(h) Qiraja operative**

Pagesat e kryera sipas qirasë operative njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve mbi baza lineare gjatë kohëzgjatjes së qirasë. Pagesat nxitëse të qirasë të marra njihen si pjesë integrale e shpenzimit total të qirasë, përgjatë kohëzgjatjes së qirasë.

#### **(i) Zhvlerësimi**

##### *(i) Aktivet financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka evidence objektive që tregon se një ose më tepër ngjarje që kanë ndodhur kanë patur një ndikim negativ në flukset e çmuara të ardhshme të mjeteve monetare të aktivitetit financiar.

Humbja nga zhvlerësimi i një aktiviteti financiar të matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferencë ndërmjet vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare skontuar me normën fillestare të interesit efektiv.

Aktivitetet financiare individuale materiale, janë testuar për zhvlerësim mbi baza individuale. Aktivitetet e mbetura financiare janë vlerësuar se bashku në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut të kreditimit. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret në rast se rimarrja mund të lidhet në mënyrë objektive me ngjarje që ndodhin pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Rimarrja njihet në të ardhura dhe shpenzime.

##### *(ii) Aktivet jo-financiare*

Vlerat në pasqyrat financiare të Shoqërisë për aktivitetet jo-financiare, përveç inventarëve, rishikohen në çdo datë raportimi, nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësimin. Në rast se ekziston një tregues i tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Një humbje nga zhvlerësimi njihet kur vlera e mbartur e një aktiviteti tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet kur vlera e mbartur e një aktiviteti ose e njësisë përkatëse të gjenerimit të parasë, tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Një njësi gjenerimi e parasë është grupi më i vogël, i identifikueshëm i aktiveve, i cili gjeneron flukse parasht të cilat janë të pavarura nga aktive dhe grupe të tjera. Humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Vlera e rikuperueshme e aktivitetit ose njësisë së gjenerimit të parasë është më e madhja mes vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë, minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të parasë skontohen, duke përdorur përqindjen e skontimit para taksës, që reflekton vlerësimet aktuale të tregut, të vlerës në kohë të parasë, dhe risqet specifike të aktivitetit.

Në lidhje me aktivitetet e tjera, një humbje nga zhvlerësimi rimerret kur ka tregues se zhvlerësimi nuk ekziston më dhe ka ndodhur një ndryshim në vlerësimet e përdorur për të caktuar vlerën e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret në masën që vlera e mbetur e aktivitetit, nuk tejkalon vlerën kontabël, neto nga amortizimi, në rast se nuk do ishte njohur humbje nga zhvlerësimi.

## **Energji Ashta Sh.p.k.**

Shënime për pasqyrat financiare  
(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

### **3. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIMI)**

#### **(j) Përfitimet e punonjësve**

*Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore*

Shoqëria, në rrjedhën normale të biznesit, kryen pagesa në emër të saj dhe të punonjësve të saj në vend, si kontributit të detyrueshëm të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, sipas legjislacionit vendas. Kostot në e Shoqërisë njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në periudhën kur ndodhin.

#### **(k) Shpenzimet operative**

Shpenzimet operative njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në periudhën në të cilën ndodhin.

#### **(l) Të ardhurat dhe kostot financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat nga fondet e investuara. Të ardhurat nga interesat njihen ndërsa përlogariten në pasqyrën e të ardhurave, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet dhe humbjet nga veprimet në monedhë të huaj raportohen në baza neto.

#### **(m) Tatimi mbi të ardhurat**

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në fitim ose humbje me përjashtim të pjesës që lidhet me zërat e njohur direkt në kapital ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi aktual është shuma e pagueshme ose e rikuperueshme e tatimeve mbi të ardhurat në lidhje me fitimin ose humbjen e tatueshme për një periudhë, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në datën e raportimit dhe çdo rregullim për tatimin e pagueshëm të viteve të mëparshme.

Tatimi i shtyrë është llogaritur në përputhje me diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë matet me normat e tatimit që pritet të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato të ndryshojnë, bazuar në ligjet që janë në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në datën e raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për atë sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit të mund të përdoren diferencat e përkohshme. Aktivet tatimore të shtyra janë rishikuar në çdo datë raportimi dhe janë pakësuar për pjesën mbi të cilën nuk është më e mundur të realizohet përfitimi fiskal.

Në përcaktimin e shumës së tatimit aktual dhe të shtyrë Shoqëria merr parasysh ndikimin e pozicioneve të pasigurta tatimore dhe nëse ka detyrime të tjera për taksat dhe interesa. Shoqëria beson se përlogaritjet e saj për detyrimet tatimore janë të përshtatshme për të gjitha vitet tatimore të hapura bazuar në vlerësimin e saj të shumë faktorëve, duke përfshirë edhe interpretimet e ligjit të taksave dhe përvojës së mëparshme. Kjo llogaritje mbështetet në vlerësime dhe supozime dhe mund të përfshijë një sërë gjykimesh rreth ngjarjeve të ardhshme.

#### **(n) Transaksione në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj janë përkthyer në monedhën funksionale raportuese, me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit janë përkthyer në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në atë datë. Humbja ose fitimi nga zërat monetare, është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj, e përkthyer me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Aktivet dhe detyrimet jo monetare në monedhë të huaj të cilat janë matur me vlerën e drejtë, përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e përcaktimit të vlerës së drejtë, kurse ato që maten me kosto historike janë konvertuar me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

**Energji Ashta Sh.p.k.**

## Notes to the financial statements

*(Amounts in Lek, unless otherwise stated)***4. MJETE MONETARE**

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Llogari rrjedhëse		
<i>Në Lek</i>	23,736,774	21,708,603
<i>Në Euro</i>	35,369,800	13,474,479
<b>Totali</b>	<u>59,106,574</u>	<u>35,183,082</u>

**5. DEPOZITA E MJETE MONETARE TE KUFIZUARA**

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Depozitat e kufizuara dhe interesi i perfllogaritur		
<i>Depozite e bllokuar si garanci per Operatorin e Sistemit te Transmetimit</i>	17,857,222	17,857,222
<i>Interes i perfllogaritur</i>	696,000	426,000
<i>Depozite e bllokuar si garanci per Drejtorine e Tatimpaguesve te Medhenj</i>	12,360,000	-
<b>Total</b>	<u>30,913,222</u>	<u>18,283,222</u>

Gjate vitit 2016 Shoqeria vendosi zevendesimin e depozites te bllokuar si garanci per Ministrine e Energjitikes dhe Industrise me nje Leter Garancie ne shume prej 8 milion Euro te leshuar nga banka Societe Generale Albania. Ne menyre qe banka Societe Generale Albania te merrte garanci te arsyeshme Shoqerite e lidhura EVN AG dhe VERBUND AG i kane leshuar asaj Garanci Korporatash ne shumat 4 milion Euro secila.

Gjate Vitit 2018 Shoqeria ishte objekt kontrolli tatimor per periudhen 2012-2016 tatim fitimi si dhe per periudhen Prill 2014-Qershor 2017 per tatimet taksa e te tjera. Si rezultat i kontrollit tatimor shoqeria ka detyrime tatimore per tu paguar, per te cilat shoqeria eshte ne proces apelimi dhe ka leshuar nje garanci bankare per Drejtorine e Tatimpaguesve te Medhenj.

**6. AKTIVE TË TJERA**

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Parapagime për tatim fitimin	8,360,102	8,360,102
Parapagime përfurnitorët	-	39,888
<b>Totali</b>	<u>8,360,102</u>	<u>8,399,990</u>

**7. LLOGARI TË ARKËTUESHME**

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Llogri te arketueshme	275,685,280	302,721,022
<b>Total</b>	<u>275,685,280</u>	<u>302,721,022</u>

Llogarite e arketueshme perbehen kryesisht nga Shoqeria OSHEE, qe eshte klienti i vetem qe blen energjine e prodhuar. Shoqeria OSHEE ka pajisur Shoqerine me nje Leter Garancie leshuar nga Banka CREDINS ne Shumen 3 milion Euro, e lidhur me detyrimet e Bleresit bazuar ne marrëveshjen 'Off-Take'.



**Energji Ashta Sh.p.k.**

Notes to the financial statements

(Amounts in Lek, unless otherwise stated)

**8. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE**

Kosto	Toka dhe ndërtesa	Makineri	Instalime elektrike	Aktive të tjera të materiale	Total
<b>Më 1 janar 2017</b>	-	-	-	81.451.769	81.451.769
Shtesa	-	-	-	8.185.378	8.185.378
Pakësime	-	-	-	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2017</b>	-	-	-	89.637.147	89.637.147
Shtesa	-	-	-	6.769.841	6.769.841
Pakësime	-	-	-	-7.715.565	-7.715.565
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	-	-	-	88.691.423	88.691.423
<b>Amortizimi dhe zhvlerësimi i akumuluar</b>					
<b>Më 1 janar 2017</b>	-	-	-	-44.083.601	-44.083.601
Pakësime	-	-	-	0	0
Shpenzim amortizimi i vitit	-	-	-	-7.869.522	-7.869.522
<b>Më 31 dhjetor 2017</b>	-	-	-	-51.953.123	-51.953.123
Pakësime	-	-	-	5.491.416	5.491.416
Shpenzim amortizimi i vitit	-	-	-	-8.085.776	-8.085.776
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	-	-	-	-54.547.483	-54.547.483
<b>Vlera e mbartur</b>					
<b>Më 1 janar 2017</b>	-	-	-	37.368.168	37.368.168
<b>Më 31 dhjetor 2017</b>	-	-	-	37.684.024	37.684.024
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	-	-	-	34.143.940	34.143.940

**Energji Ashta Sh.p.k.****Shënime për pasqyrat financiare***(Shumat në Lek, nëse nuk është shprehur ndryshe)***9. AKTIVE JO-MATERIALE**

	<b>Total</b>
<b>Kosto</b>	
Më 1 janar 2017	30,317,882,971
Shtesa	-
Më 31 dhjetor 2017	30,317,882,971
Shtesa	-
Më 31 dhjetor 2018	30,317,882,971
<b>Amortizimi dhe zhvlerësimi i akumuluar</b>	
Më 1 janar 2017	(9,499,099,835)
Shpenzim amortizimi i vitit	(775,855,273)
Më 31 dhjetor 2017	(10,274,955,108)
Shpenzim amortizimi i vitit	(775,855,273)
Më 31 dhjetor 2018	(11,050,810,381)
<b>Vlera e mbartur</b>	
Më 1 janar 2017	20,818,783,136
Më 31 dhjetor 2017	20,042,927,863
Më 31 dhjetor 2018	19,267,072,590

Në vitet e mëparshme, uljaepritshmërisë për Energji Ashta Shpk në lidhje me të ardhurat nga shitja e certifikatave përpakësim ndotjesh (CER) ishin tregues tezhvlerësimit, siç ishin dhe shpenzimet për investime dhe rreziku i vendit me ndikim në normën e skontimit. Më 31 dhjetor 2013, humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi për aktivet afatgjata ishin 5,919,292,889 Lek. Në vijimtestitë zhvlerësimit të kryera në vitin 2015, nuk është identifikuarzhvlerësimimëtejshëm.

Përcaktimi i vlerës në përdorim u bazua mbi një nivel konstant prodhimi gjatë periudhës së planifikimit që korrespondon me kapacitetin mesatar të energjisë. Periudha e planifikimit përfshiu afatin e pritshëm të koncesionit të hidrocentralit.Vlera në përdorim u përcaktua me metodën e skontimit të flukseve të ardhshme të parasë (DCF) me normë skontimi para tatimit për periudhën e planifikimit nga 8.25% në 9.0% në vit.

Supozimet kryesore për vlerësimin mbi të cilat u mbështet përcaktimi i shumës së rikuperueshme, përfshijnë çmimet e parashikuara të energjisë për periudhën pas përfundimit të marrëveshjes për blerjen e energjisë me KESH/OSHEE (shënimi 1) dhe normën e skontimit. Çmimet për 15 vitet e para pas komisionimit u përcaktuan në bazë të marrëveshjes së blerjes të energjisë elektrike me KESH-in, ndërsa çmimet e energjisë elektrike për vitet më pas u përcaktuan në bazë të një modeli të brendshëm të tregut të energjisë.

Me date 31 dhjetor 2018 dhe me 31 dhjetor 2017 Drejtimi i Shoqërisë konkuldoi se nuk ka ndryshime të rëndësishme/materiale të supozimeve për kalkulimin e zhvlerësimit që nga testi i zhvlerësimit i kryer me 31 dhjetor 2015. Për këto arsye nuk është bërë ndonjë llogaritje për zhvlerësimin dhe nuk është njohur ndonjë rezervë shtese për zhvlerësimin.

## **Energji Ashta Sh.p.k.**

### **Shënime për pasqyrat financiare**

*(Shumat në Lek, nëse nuk është shprehur ndryshe)*

#### **10. KAPITALI AKSIONAR**

Kapitali i paguar është i regjistruar në Lek. Energji Ashta Sh.p.k. fillimisht ishte në pronësi të Verbund-International GmbH. Disa transferime pasuese të kapitalit aksionar u bazuan në marrëveshjet e blerjes së aksioneve si më poshtë:

- 20 prill 2010: 50% e kapitalit aksionar u transferua nga VERBUND-International GmbH tek EVN AG;
- 13 janar 2011: 50% e kapitalit aksionar u transferua nga VERBUND-International GmbH tek VERBUND Hydro Power GmbH;
- 6 shtator 2011: VERBUND Hydro Power GmbH dhe EVN AG transferuan 100% të aksioneve tek Ashta Beteiligungsverwaltung GmbH, ndërkohë që kjo e fundit mbetet në pronësi të këtyre dy shoqërive;
- 20 tetor 2015: Bazuar në vendimin e aksionarit, kapitali aksionar i Shoqërisë u rrit nëpërmjet kontributit në parimë shumën 1,677,720,000 Lek.

Struktura e pronësisë është si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2018</b>		<b>31 dhjetor 2017</b>	
	<b>Total në Lek</b>	<b>%</b>	<b>Total në Lek</b>	<b>%</b>
Ashta Beteiligungsverwaltung GmbH	12,460,176,500	100	12,460,176,500	100

#### **11. DETYRIMET NDAJ PALEVE TE LIDHURA**

Detyrimet ndaj palëve të lidhura paraqesintëricën e një llogarie me VERBUND Finanzierungsservice GmbH. Kjo llogari përdoret për të mbledhur ose shlyer pagesat me palët e treta ose palët e lidhura, dhe për të marrë fonde nga pronarët. Këto teprica janë në Euro dhe mbartin një interes 1-mujor Euribor + 3%. (2017: Euribor +3%)

#### **12. TE PAGUESHME DHE DETYRIME TE TJERA**

	<b>31 dhjetor 2018</b>	<b>31 dhjetor 2017</b>
TVSH e pagueshme	25,603,602	33,403,762
Detyrime të tjera ndaj furnitorëve	15,448,342	36,747,465
Shpenzime të përlogaritura	631,880	2,398,350
Tatim mbi të ardhurat personale	436,638	469,214
Sigurime shoqërore	649,114	667,335
Detyrime dhe taksa të tjera	1,273,867	999,029
<b>Totali</b>	<b>44,043,443</b>	<b>74,685,155</b>

**Energji Ashta Sh.p.k.****Shënime për pasqyrat financiare***(Shumat në Lek, nëse nuk është shprehur ndryshe)***13. HUATE AFATGJATA**

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
VERBUND AG	6,417,620,321	7,381,164,300
Raiffeisen Bank International	6,417,620,321	7,381,164,300
<b>Totali</b>	<b>12,835,240,642</b>	<b>14,762,328,600</b>
<b>Detyrimi afatshkurtër</b>	<b>956,065,642</b>	<b>1,035,241,100</b>
<b>Detyrimi afatgjatë</b>	<b>11,879,175,000</b>	<b>13,727,087,500</b>

Huatënga Raiffeisen Bank International dhe VERBUNDAG mbajnë normë interesi fikse, aktualisht prej 3.38%. Huamarrjet janë të pagueshme në tridhjetë e pesë këste tremujore duke filluar nga 15 tetori 2013. Huatë janë garantuar nga aksionarët e Shoqërisë meme, dhe për këto garanci Shoqëria u paguan atyre, një tarifë prej 2% mbi shumën e mbetur të huave.

**14. TË ARDHURAT**

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2017
Shitja e energjisë	2,324,026,543	1,445,111,298
Kompensimet për energji	16,080,554	12,280,217
Shitja e CER's	6,833,755	15,972,906
<b>Totali</b>	<b>2,346,940,852</b>	<b>1,473,364,421</b>

Te ardhurat nga shitja e energjisë, rrjedhin nga Licensa për Prodhimin e Energjisë Elektrike. Te ardhurat për dy licencat e tjera ato të Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike dhe Tregtimit të Energjisë Elektrike janë zero.

Të ardhurat nga shitja e CER gjatë vitit 2018, kanë të bëjnë me shitjen e te drejtave të Reduktimit të Emetimeve të Dioksidit të Karbonit në Natyrë (CER'S) të lëshuara nga Projekti mbi Mekanizmin për Zhvillimin e Pastër (CDM) kundrejt VERBUND Trading GmbH.

**15. KOSTOT E PERSONELIT**

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2017
Paga dhe shpërblime	49,040,827	48,689,953
Sigurime shoqërore	4,700,556	4,741,938
Shpenzime të tjera të personelit	1,008,730	-
<b>Totali</b>	<b>54,750,113</b>	<b>53,431,891</b>

Shpenzime të tjera të personelit kanë të bëjnë me kontribute vullnetare shëndetësore. Në 31 dhjetor 2018, Shoqëria kishte punësuar 23 punonjës (2017: 23)

**Energji Ashta Sh.p.k.****Shënime për pasqyrat financiare***(Shumat në Lek, nëse nuk është shprehur ndryshe)***16. SHPENZIME TË TJERA OPERATIVE**

Shpenzimet e tjera operative përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2017
Shërbime profesionale konsulence	36,832,674	33,427,008
Tarifa koncesioni	46,336,035	28,181,769
Mirëmbajtje dhe riparime	18,779,945	18,328,416
Shpensime për sigurime	19,343,371	19,509,099
Kostot e kompensimit të energjisë - OST	45,266,613	135,513,310
Shpenzime për IT	8,876,505	10,049,925
Shpenzime postare dhe telefoni	3,669,259	4,257,890
Shpensime për automjetet	3,443,326	3,282,228
Shpensime për udhetime e dieta	3,124,807	3,956,421
Materiale zyre	1,523,550	2,473,080
Shpensime transporti	1,320,337	2,475,194
Shpensime auditimi	987,320	1,071,200
Shpensime për mjekim	1,206,912	1,297,800
Shpensime për trajnime	573,115	2,509,248
Taksa dhe tarifa të tjera	3,383,899	5,675,513
Komisione bankare	216,490	198,278
Shpensime përfaqësimi	1,387,981	1,319,225
Shpensime qiraje	677,739	1,995,958
Shpensime për marrënie me publikun	1,486,551	1,256,235
Shpensime sponsorizimi	825,674	482,012
Humbje nga rojçerë jashtë përdorimit	562,340	-
Gjoha dhe penalitete	60,000	1,139,404
Të tjera	2,063,183	3,680,013
<b>Totali</b>	<b>201,947,625</b>	<b>282,079,226</b>

Bazuar në marrëveshjen e koncesionit, duke filluar prej Korrikut 2013, Shoqëria paguan tarifë koncesioni prej 2% të prodhimit neto të energjisë.

**17. TATIMI MBI FITIMIN**

Shoqëria përcakton tatimin në fund të vitit në përputhje me legjislacionin tatimor shqiptar. Në vitin 2018, norma e tatimit fitimit në Shqipëri ishte 15%, (2017:15%). Më poshtë paraqitet rakordimi i tatimit fitimit të përlogaritur me normat përkatëse me shpenzimin e tatimit:

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2017
Fitim/(humbje) para tatimit fitimit	1,525,144,255	(291,775,659)
Total shpenzimet e pazbritshme	1,570,856	5,035,005
Ndryshime në provigjione	-1,766,470	46,470
Shpensime transporti	1,010,673	2,047,894
Sponsorizime	825,674	482,012
Shpensime përfaqësimi	1,415,780	1,319,225
Gjoha dhe penalitete	60,000	1,139,404
Shpensimi, masa e të cilit nuk vertetohet me dokumenta	25,200	-
Shtese amortizimi tatimor	(386,753,351)	-
<b>(Humbja e zbriteshme) / fitimi i tatueshem</b>	<b>1,139,961,760</b>	<b>(286,740,654)</b>
<b>Humbjet tatimore të mbartura</b>	<b>(286,740,651)</b>	<b>(550,921,163)</b>
<b>Tatimi mbi fitimin prej 15% (2017: 15%)</b>	<b>127,983,166</b>	<b>-</b>

**Energji Ashta Sh.p.k.****Shënime për pasqyrat financiare***(Shumat në Lek, nëse nuk është shprehur ndryshe)***17 TATIMI MBI FITIMIN (VAZHDIM)**

Në bazë të legjislacionit Shqiptar humbjet tatimore mbarten deri në tre vjet rresht, Humbjet tatimore të mbartura në 31 dhjetor 2018 dhe 2017 janë si më poshtë:

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2017
Humbje tatimore nga 2014 (shuhen në 2018)	(810,875,464)	(810,875,464)
Humbje tatimore nga 2014 perdorur në 2016	259,954,301	259,954,301
Humbje tatimore nga 2014 të rregulluara nga kontrolli tatimor	550,921,163	-
Humbje tatimore nga 2017 (shuhen në 2020)	(286,740,651)	(286,740,651)
Humbje tatimore nga 2017 perdorur në 2018	286,740,651	-
<b>Total</b>	<b>-</b>	<b>(837,661,814)</b>

Diferencat e perkohshme të zbritshme midis bazës tatimore dhe bazës kontabel të aktive jo-materiale (të paraqitura në shënimin 9) si pasojë e zhvleresimit ishin në 31 Dhjetor 2018 4,802,187,442 Lek. Drejtimi i Shoqërisë ka vlerësuar një aktiv tatimor të shtyre sikurse prezantohet më poshtë dhe konsiderohet i rikuperueshem gjatë periudhës së Marrveshjes së Koncesionit.

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2017
Diferenca të perkohshme të zbritshme	4,802,187,442	-
<b>Aktiv tatimi i shtyre 15%</b>	<b>720,328,116</b>	<b>-</b>

**18. ANGAZHIME DHE KUSHTEZIME***Angazhime*

Shoqëria nuk ka angazhime materiale të nenkontraktuara në datën e pasqyres së pozicionit financiar të cilat të mos jenë reflektuar në pasqyrat financiare.

*Detyrime tatimore*

Librat dhe të dhenat kontabel për vitet financiare që perfundojnë më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 nuk janë audituar nga autoritetet tatimore. Si rrjedhim, detyrimet tatimore të Shoqërisë mund të mos konsiderohen të finalizuara.

*Çeshtje Gjyqësore*

Në rrjedhën normale të biznesit, Shoqëria ndeshet me pretendimet ligjore dhe gjyqësore; menaxhimi i Shoqërisë është i mendimit se asnjë humbje materiale nuk do të shkaktohet në lidhje me kërkesat ligjore të pazgjidhura më 31 dhjetor 2018.

**Energji Ashta Sh.p.k.**  
**Shënime për pasqyrat financiare**

*(Shumat ne Lek, nëse nuk është shprehur ndryshe)*

**19. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA**

Shoqëria ka marrë financim nga palët e lidhura dhe garanci prej tyre për huatë që ka marrë (shih shënimet 11 dhe 13). Shpenzimet e paguara për palët e lidhura ishin si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2018</b>	<b>31 Dhjetor 2017</b>
<i>Detyrime</i>		
VERBUND Finanzierungs service GmbH	239,430,451	577,004,708
VERBUND AG	6,417,620,321	7,381,164,300
<b>Total</b>	<b>6,657,050,772</b>	<b>7,958,169,008</b>
	<b>Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2018</b>	<b>Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2017</b>
<i>Te ardhura</i>		
VERBUND Trading GmbH	6,833,755	7,986,453
EVN AG	-	7,986,453
<b>Total</b>	<b>6,833,755</b>	<b>15,972,906</b>
<i>Shpenzime operative</i>		
VERBUND Hydro Power GmbH	5,087,945	9,369,836
VERBUND Services GmbH	10,425,698	10,974,332
VERBUND Finanzierungs service GmbH	299,333	358,218
<b>Total</b>	<b>15,812,976</b>	<b>20,702,386</b>
<i>Kostot e financimit</i>		
VERBUND AG	242,766,376	274,273,503
VERBUND Finanzierungs service GmbH	19,302,523	14,193,535
EVN AG-Tarife garancie	150,324,856	165,639,627
VERBUND Hydro Power GmbH-Tarife garancie	138,054,393	153,692,046
VERBUND AG-Tarife garancie	12,270,463	11,947,580
<b>Total</b>	<b>562,718,611</b>	<b>619,746,291</b>

**Energji Ashta Sh.p.k.**

Shënime për pasqyrat financiare

*(Shumat në Lek, nëse nuk është shprehur ndryshe)*

---

**20. NGJARJET PAS DATES SE RAPORTIMIT**

Nuk ka pasur ndonjë ngjarje pasuese domethënëse pas datës së raportimit që do të kërkonte rregullim ose shpjegim në këto pasqyra financiare.